



Бр/№. _____
Скопје/Shkup _____ година/viti

PLANI VJETOR I PARANDALIMIT TË KORRUPSIONIT I NDËRMARRJES PUBLIKE TË RRUGËVE SHTETËRORE PËR VITIN 2021

Në pajtim me Ligjin e Parandalimit të Korrupsionit dhe Përplasjen e Interesave, Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore, duke vepruar sipas Konkluzionit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.40-2929/1, më 02.02.2021, miratoi këtë Plan të Parandalimit të Korrupsionit, ku detyra kryesore do të jetë detektimi në kohë i rreziqeve nga korrupsioni dhe propozimi i masave përkatëse për largimin e rreziqeve dhe do të jetë udhëheqës për aktivitetet e mëtutjeshme që Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore do t'i marrë për luftë kundër korrupsionit.

Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore si institucion që kryen punë me interes publik, ka për qëllim të vendos sistem masash që do të mundësojnë menaxhimin e korrupsionit dhe identifikimin e shkaqeve, kushteve dhe faktorëve që e mundësojnë.

Më pas, interesi publik, ashtu siç është i përkufizuar në Ligjin e Parandalimit të Korrupsionit dhe Përplasjes së Interesave, paraqet “mbrojtje të lirive dhe të drejtave elementare të njeriut dhe qytetarit, të pranuar me të drejtën ndërkombëtare dhe të vërtetuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, parandalimin e rreziqeve për shëndetin, mbrojtjen dhe sigurinë, mbrojtjen e mjedisit jetësorë dhe natyrës, mbrojtjen e pronësisë dhe lirisë së tregut dhe veprimtarisë sipërmarrëse, sundimin e të së drejtës dhe parandalimin e krimit dhe korrupsionit”.

Nën korrupsion, në kuptim të Ligjit të Parandalimit të Korrupsionit dhe Përplasjes së Interesit, nënkuptohet keqpërdorimi i funksionit, autorizimit publike, detyra zyrtare ose pozicioni për realizimit e ndonjë dobie, drejtpërdrejtë ose nëpërmjet ndonjë ndërmjetësit, për vete apo për dikë tjetër, kështu që, duke pasur parasysh që korrupsioni cenon të drejtat e qytetarëve, e pamundëson drejtësinë, e varfëron shoqërinë dhe e shkatërron shtetin juridik, është e domosdoshme që lufta kundër korrupsionit të jetë obligim i vazhdueshëm çdo punonjësi në Ndërmarrjen Publike të Rrugëve Shtetërore.





Është obligim i të gjithëve punonjësve që gjatë realizimit të detyrave të punës të veprojnë sipas kushtetutës, ligjeve, të manifestojnë shkallë të lartë të integritetit në punë, t'i njohë format e korrupsionit dhe të posedojë aftësi që ta kundërshtojë korrupsionin.

Me këtë plan, përforcohen kapacitetet dhe vendoset një sistem i sinkronizuar për funksionim efikas të institucioneve kundër korrupsionit, për kthimin e besimit të qytetarëve dhe shoqërinë, e liruar nga korrupsioni edhe atë nëpërmjet këtyre synimeve dhe aktiviteteve:

1. Përforcimi i integritetit të punonjësve të NPRRSH

Theks i veçantë në luftën kundër korrupsionit vendoset në avancimin e integritetit personal dhe profesional të punonjësve prej të cilëve pritet që gjatë realizimit të detyrave të punës të zbatojnë njohuri përkatëse, kapacitet etik, ndershmëri dhe të punojnë në dobi të interesit publik dhe rritjen e besimit në publik.

Termi integritet nënkupton kryerje të ligjshme, të pavarur, të paanshme, etike, të përgjegjshme dhe transparente të punëve me të cilat punonjësit e ruajnë reputacionin e tyre dhe të ndërmarrjes.

Termi integritet në vete përfshin integritetin individual dhe institucional.

Integriteti individual nënkupton raport personal ndaj çështjeve të korrupsionit, përplasjen e interesave, interesin publik dhe aftësinë e ndërtimit të rezistencës. Integriteti institucional nënkupton rezistencë ndaj korrupsionit dhe nënkupton sistem të vendosur të politikave, standardeve, mekanizmave dhe procedurave, që e ulin rrezikun e sjelljes korruptive nga punonjësit dhe në anën tjetër i motivojnë për raport të ndershëm dhe profesional gjatë kryerjes së obligimeve të punës. Ndërmarrja publike në vazhdimësi do të punojë në përforcimin e integritetit në nivelin personal dhe institucional, me qëllim të mirëmbajtjes dhe zhvillimit të besimit në publik. Punonjësit në ndërmarrje obligohen t'i respektojnë dhe zbatojnë rregullat ligjore, aktet nënligjore, procedurat e brendshme, me ndërgjegje, përgjegjësi, në mënyrë profesionale dhe të paanshme. Vetëm me veprim profesional, ligjor dhe etik do të përforcohet integriteti i punonjësve, e me këtë edhe do të kontribuohet për largimin e mundësisë për paraqitjen e korrupsionit.

2. Respektimi i kodeve

Çdo punonjës në ndërmarrjen publike duhet të ketë njohuri të lartë të kodeve të etikës.

Kodi i Nëpunësve Administrativë si dhe Kodi i Sjelljes së Punonjësve në Njësinë e Pagesës së Pikave Pagesore dhe Kontrollit, me të cilat janë të njohur të gjithë





punonjësit në ndërmarrje dhe që janë publikisht të arritshme në faqen e internetit të Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore, janë bazat për sjelljen etike të të gjithë punonjësve. Çdo mosrespektim i kodit nga punonjësit paraqet bazë për fillimin e procedurës disiplinore.

Me kodin e nëpunësve administrativ përcaktohen standardet etike dhe rregullat e sjelljes së nëpunësve administrativë dhe qëllimi i këtij kodi është të inkurajojë veprimin e mirë dhe sjelljen e nëpunësve administrativë dhe të forcojë besimin e qytetarëve në punën e institucioneve të sektorit publik.

Parimet themelore në punën për punonjësit në Njësinë e Pagesës së Pikave Pagesore dhe Kontrollit, sipas Kodit janë:

- profesionalizmi, ndërgjegjja, ndershmeria dhe përgjegjësia në kryerjen e detyrave dhe obligimeve të punës në pajtim me Kushtetutën, ligjet, aktet nënligjore, aktet e përgjithshme të Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, pa diskriminim dhe privilegj dhe pa ndonjë interes personal

Përkushtim në punë

- Ruajtja e reputacionit dhe dinjitetit personal dhe reputacionit të Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore, duke shmangur situata dhe sjellje që mund të dëmtojnë interesin ose reputacionin e Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore.

- Shmangia e përdorimit të statusit ose ndikimit për të kënaqur interesat individuale materiale dhe personale, interesat e anëtarëve të familjes së tyre

Shmangia e çdo lloj sjellje jokorrekte etike

Respektimi i të drejtave dhe dinjitetit të njerëzve të tjerë

- Gjatë kryerjes së detyrave të tyre të punës, punëtorët nuk duhet të drejtohen nga bindjet e tyre politike, interesat personale, financiare dhe nuk duhet të keqpërdorin me autoritetin e tyre.

Për shkak të zbatimit të kodeve, nevojitet qasje sistemore që do të mundësojë që kodet të kuptohen, pranohen dhe zbatohen nga të gjithë punonjësit e Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore.

3. Zbatimi i vlerësimit të rrezikut nga paraqitja e korrupsionit

Puna në Ndërmarrjen Publike të Rrugëve Shtetërore si dhe në çdo institucion mund t'i nënshtrohet sjelljes korruptive. Vlerësimi i rrezikut nga korrupsioni do të mundësojë vendosjen e një sistemit për parandalimin e korrupsionit të bazuar në dëshmi dhe do të mundësojë përdorim efikas të burimeve të disponueshme që të arrihet realizimi i rezultateve në luftën kundër korrupsionit. Nevojitet qartë të identifikohen kategoritë e vendeve të punës me rrezik më të madh nga





korrupsioni. Prandaj, nevojitet të gjendet një modus nëpërmjet trajnimeve të punonjësve nga fusha e vlerësimit të rrezikut dhe menaxhimit me rrezik, por edhe përfshirjen e Njesisë së Revizionit të Brendshëm për gjetjen e mënyrave që të vlerësohen rreziqet kryesore nga korrupsioni dhe të bëhen metodologji me propozim të masave për uljen dhe largimin e formave të ndryshme të rreziqeve. Akt juridik që e rregullon menaxhimin e rreziqeve (të korrupsionit) në sektorin publik është Ligji i Parandalimit të Korrupsionit, që duhet të jetë udhëheqës gjatë vlerësimit të rrezikut nga korrupsioni.

4. Zbatimi i procedurave të përcaktuara për punë në proceset e punës së NPRRSH

Përforcimi i integritetit të institucioneve është temë shumë e rëndësishme si për procesin e reformave në administratën publike ashtu edhe për parandalimin e korrupsionit. Përkatësisht, që të zbatohet transparenca në punën e institucionit, përgjegjësia, ndershmëria, puna etnike e punonjësve ose administratë profesional dhe të depolitizuar dhe realizimi i administratës cilësore ku korrupsioni është në nivelin minimal, duhet të ketë procedura të shkruara të punës dhe proceseve të punës në Ndërmarrjen Publike të Rrugëve Shtetërore në çdo segment dhe fushë të punës.

Në Ndërmarrjen Publike të Rrugëve Shtetërore ekzistojnë procedura të përcaktuara që duhet vazhdimisht të përditësohen dhe përmirësohen sipas proceseve të punës së njësive organizative në ndërmarrje si dhe ndjekjen e veprimit të punonjësve. Në këtë mënyrë do të eliminohen rreziqet e paraqitjes së sjelljes korruptive të punonjësve në Ndërmarrjen Publike.

5. Profesionalizimi, departizimi dhe depolitizimi i punonjësve

Një administratë profesionale e departizuar, e bazuar në merita është baza në luftë kundër korrupsionit. Gjatë punësimit në Ndërmarrjen Publike duhet në përpikëri të respektohen të gjitha procedurat dhe rregullat ligjore, sidomos aktet ligjore dhe nënligjore sipas të cilave bëhet punësimi dhe avancimi i punonjësve në Ndërmarrjen Publike të Rrugëve Shtetërore përkatësisht Ligji i Nëpunësve Administrativ, Ligji i Punonjësve në Sektorin Privat, Ligji i Ndërmarrjeve Publike dhe Ligji i Marrëdhënieve të Punës.

Gjithashtu duhet të vendoset procedurë e barabartë për përzgjedhjen dhe emërimin e pozitave udhëheqëse, e bazuar mbi parimet e meritës, qasjes së barabartë në vend pune me kushte të njëjta, përfaqësim përkatës dhe të drejtë dhe barazi gjinore. Detyrat e punës nevojitet të bëhen në mënyrë të paanshme politikisht, pa ndikimin e interesave personale, bindjeve politike apo interesave





financiare, me respektim të përpiktë të synimeve, reputacionit dhe integritetit të Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore.

6. Trajnime të vazhdueshme të punonjësve

Punonjësit në Ndërmarrjen Publike të Rrugëve Shtetërore nevojitet t'i përmbushin kërkesat e larta lidhur me llojin e arsimit, kualifikimet, reputacionin, kompetencat personale dhe profesionale gjatë punës dhe për këto shkaqe, përforcimin e integritetit të punonjësve dhe ndërtimin e kulturës së mos tolerancës ndaj korrupsionit, duke vizituar trajnime nga fusha e luftës kundër korrupsionit, Ligji i Qasjes së Lirë në Informacione me Karakter Publik dhe gjetja e mundësive dhe trajnimeve përkatëse nga fusha e integritetit dhe zhvillimin personal e profesional, që do t'u propozohen punonjësve si dhe nxitja e punonjësve që të drejtohen dhe vetë të tregojnë interes për gjetjen dhe vizitimin e trajnimeve që janë në drejtim të sigurimit të efikasitetit më të madh në punë. Trajnimet që do të zbatohen do të jenë gjenerike, nëpërmjet MSHIA si dhe të specializuara dhe do të zbatohen për të gjithë punonjësit e Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore, dhe të njëjtit obligohen në aspekt profesional të aftësohen për punën që e kryejnë në vendin e tyre të punës, për fitimin e shkathtësive dhe njohurive nëpër programet e organizuara.

7. Kontroll i përforcuar dhe vëzhgimi i furnizimeve publike

Analiza e furnizimeve publike nga viti paraprak financiar. Përforcimi i kapaciteteve me kuadro të kualifikuara dhe të trajnuara për zbatimin e furnizimeve publike, nëpërmjet zbatimit të trajnimeve për furnizime publike për të gjithë punonjësit në Sektorin e Furnizimeve Publike dhe numrit sa më të madh të punonjësve që marrin pjesë në komisionet e furnizimeve publike. Funksim të plotë të parimeve themelore të furnizimeve publike: transparencë, konkurrencë, trajnim të barabartë të operatorëve ekonomik, mos diskriminim, ligjshmëri, shfrytëzim ekonomik, efikas, efektiv dhe racional të mjeteve buxhetore, këmbëngulja që të merret oferta e mirë me kushtet më të volitshme si dhe llogaridhënia për mjetet e shpenzuara të furnizimeve.

8. Përforcimi i parimit të transparencës në punë

Nëpërmjet afrimit të shërbimeve të qytetarët, rritet transparenca, efektiviteti, efikasiteti, qasja, kontrolli i ndërmarrjes dhe përforcohet besimi i qytetarëve që është themeli në luftën kundër korrupsionit. Zbatimi i përpiktë i Ligjit të Qasjes së Lirë në Informacione me Karakter Publik nëpërmjet shpalljes së informacioneve nga Ligji i Qasjes së Lirë në Informacione me Karakter Publik në faqen e internetit të institucionit dhe realizimi në kohë i obligimeve nga i njëjti





ligj. Për këtë ligj, Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore emëron person zyrtar për ndërmjetësim me informacione me karakter publike në Ndërmarrjen Publike të Rrugëve Shtetërore, të dhëna që janë të arritshme në faqen e internetit të ndërmarrjes.

Për luftë efektive dhe efikase me korrupsionin, institucionet duhet të kenë mekanizma efikas dhe efektiv për menaxhim me procesin e ndjekjes dhe mbikëqyrjes së gjendjes me korrupsionin si dhe për gjendjet në raport me përplasjen e interesave, integritetin dhe marrjen e dhuratave, si aspekte që janë në lidhje të drejtpërdrejtë me korrupsionin. Prandaj, Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore ka emëruar person zyrtar për pranimin e paraqitjeve të dorëzuara për paraqitje të mbrojtur të brendshme në Ndërmarrjen Publike të Rrugëve Shtetërore, të dhëna që janë të arritshme në faqen e internetit të ndërmarrjes.

9. Obligimi për zbatimin e planit për parandalimin e korrupsionit

Zbatimi i politikës së integritetit dhe parandalimit të korrupsionit është përgjegjësi e të gjithë punonjësve në Ndërmarrjen Publike të Rrugëve Shtetërore. Miratimi i këtij plani për parandalimin e korrupsionit, imponim obligime për të gjitha njësitë organizative. Për realizimin e obligimeve nga Plani i parandalimit të korrupsionit dhe me aktivitete të koordinuara të të gjitha njësive organizative në Ndërmarrjen Publike të Rrugëve Shtetërore mund të ballafaqohemi me korrupsionin si dukuri negative shoqërore.

Zbatimi i Planit për parandalimin e korrupsionit është obligim i të gjithë udhëheqësve të njësive organizative në Ndërmarrjen Publike të Rrugëve Shtetërore që duhet t'i njoftojnë punonjësin me planin për parandalimin e korrupsionit. Plani vjetor për parandalimin e korrupsionit do të publikohet në faqen e internetit të Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore.

Директор
Ejup Rustemi

